



Nr. prot. 01-111/01-0077477/25
Pejë, 26.09.2025

Në mbështetje të nenit 78 paragrafi 2 neneve 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197, dhe në baze të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Pejës, publikon këtë:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët interesuar

- **Titulli i vendit të punës:** Asistent Stomatologjik
- **Klasa dhe koeficienti i pagës:** H-17,6.4 dhe H-20, 6.1
- **Kategoria:** Nëpunës i Shërbimit Publik
- **Numri i kërkuar:** Katër (4) Pozita
- **Orari i punës:** 40 orë në javë
- **Periodha e Kontratës:** Me kohë të pacaktuar
- **Kohëzgjatja e punës provuese:** Gjashtë (6) Muaj
- **Institucioni:** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF
- **Mbikëqyrësi:** Shefi i Poliklinikës
- **Data e Publikimit:** 26.09.2025
- **Afati për Aplikim:** 29.09.2025 – 27.10.2025

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën – Asistent i stomatologjisë

- Ofrimi i shërbimeve stomatologjike të kualitetit të lartë
- Përgatitë ordinancën stomatologjike – sallën dhe pacientët për punë
- Kujdeset për higjienën e sallave, laboratorit teknik dhe ordinancave stomatologjike, si dhe për mjetet e punës
- Pastron dhe sterilizon instrumentet dhe jep përgjegjësi për efikasitetin e tyre,
- Mban evidencën e pacientëve dhe materialit harxhues
- Ndhmon dhe koordinon bashkëpunimin efektiv ndërmjet shërbimeve stomatologjike
- Ndhmon dhe zhvillon sistemin informativ stomatologjik në kuadër të shërbimeve stomatologjike
- Përgjigjet për kualitetin dhe afatin kohor të punimeve protetike
- Ndhmon dhe koordinon bashkëpunimin efektiv ndërmjet shërbimeve të laboratorit teknik
- Kryen punë të tjera sipas urdhrit të udhëheqësit

Kualifikimi, përvoja dhe aftësitë për pozitën – Asistent i stomatologjisë

- Shkolla e mesme apo Bachelor – drejtimi Asistent i stomatologjisë/Teknik i dhëmbëve
- Të kenë licencën valide të punës
- Të njohin punën me kompjuter (e dëshirueshme)
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme)

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë licencën e punës;

- Njohuri profesionale me përvojën e duhur si dhe aftësi komunikuese e organizative;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për ti kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Shkolla e mesme /Bachelor – drejtimi Asistent i Stomatologjisë/Teknik i dhëmbëve
- Të ketë licencë të punës të lëshuar nga Institucionet përkatës të Republikës së Kosovës
- Formulari i aplikimit të plotësuar
- Rezumeja personale CV
- Certifikata e lindjes (origjinale)
- Letërnjoftimi(kopje)
- Certifikatën mjekësorë që vërteton aftësitë e kandidatit për detyrat e punës
- Certifikatën nga gjykata që nuk është nën hetime ose i dënuar (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Të gjithë kandidatët e interesuar, Aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në Arkivën e QKMF-së Pejë, apo ti shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Pejës <https://kk.peje.rks-gov.net/peje/> dhe portali shtetërorë <https://konkursi.rks-gov.net>. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivën e QKMF-së Pejë.

Vetëm Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto pozita , duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën Komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpriten aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i cili i bashkëngjitet aplikacionit duhet të jetë fotokopje dhe se i njëjti nuk kthehet.

Kandidatët të cilët përzgjidhen, pas shpalljes së njoftimit publik, duhet të sjellin dokumentet origjinale si dhe certifikatën mbi gjendjen shëndetësore.

Dokumentet e pakompletuara dhe të cilat nuk i përgjigjen kërkesave të konkursit, si dhe dokumentacioni qe mbërrin me vonesë nuk do të merret në shqyrtim .

Për informata më të hollësishme mund të informoheni në Zyrën e personelit të QKMF , nr. 49 apo në nr. Tel 039-423-424 çdo ditë pune deri në orën 14:00.

Rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Pejës: <http://kk.rks-gov.net/peje/>dhe në linkun :<http://konkursi.rks-gov.net/>.